**VENDIM**
**Nr.82, datë 23.1.2011**

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR HETIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONEVE SHTETËRORE PËR ZBULIMIN, IDENTIFIKIMIN, PËRBALLIMIN, NEUTRALIZIMIN, PENGIMIN DHE NDËSHKIMIN E VEPRIMIT TË ORGANIZUAR KRIMINAL PËR DHUNIMIN E INSTITUCIONEVE DHE PËRMBYSJEN E RENDIT KUSHTETUES NË DATËN 21 JANAR 2011**

Në mbështetje të neneve 77 dhe 78 të Kushtetutës, të neneve 8 e 9 të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit", si dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet komisioni hetimor i Kuvendit për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh për të hetuar veprimtarinë e institucioneve shtetërore për zbulimin, identifikimin, përballimin, neutralizimin, pengimin dhe ndëshkimin e veprimit të organizuar kriminal për dhunimin e institucioneve dhe përmbysjen e rendit kushtetues në datën 21 janar 2011.

II. Objekti i punës së komisionit hetimor është:

a) Hetimi rreth veprimtarisë së aktorëve të përfshirë për zbatimin e ligjit nr.8773, datë 23.4.2001 "Për tubimet" në demonstratën e datës 21 janar 2011.

b) Hetimi rreth veprimtarisë së institucioneve shtetërore, sipas kompetencave të përcaktuara në legjislacionin respektiv, për zbulimin dhe identifikimin paraprak të kërcënimeve dhe sinjaleve për organizimin e veprimit kriminal për përmbysjen me dhunë të rendit kushtetues, si dhe masat konkrete të marra për parandalimin, neutralizimin, pengimin dhe përballimin e dhunës gjatë ngjarjeve që shoqëruan tentativën për përmbysjen me dhunë të rendit kushtetues.

c) Hetimi rreth veprimtarisë së organeve të zbatimit të ligjit për identifikimin, kapjen dhe neutralizimin, pengimin e ekzekutorëve, identifikimin dhe kapjen e nxitësve dhe organizatorëve të dhunës kriminale.

ç) Hetimi rreth veprimtarisë së organeve të zbatimit të ligjit dhe masave të marra për zbardhjen e shpejtë e të plotë të fakteve, ngjarjeve dhe përgjegjësive të individëve, ideatorëve, ndihmësve dhe bashkëpunuesve për dhunën dhe tentativën për përmbysjen me dhunë të rendit kushtetues.

d) Hetimi i zbatimit të ligjit gjatë hartimit dhe ekzekutimit të detyrave në kuadër të planit të masave që organet shtetërore të ngarkuara me ligj përgatitën dhe zbatuan me qëllim respektimin dhe garantimin e zbatimit të detyrimit ligjor të mbrojtjes së institucioneve kushtetuese të vendit.

dh) Hetimi për masat e marra nga organet e zbatimit të ligjit për neutralizimin përfundimtar të tentativës për përmbysjen me dhunë të rendit kushtetues dhe për garantimin e paprekshmërisë së institucioneve dhe të së drejtës për tubim paqësor.

e) Propozimi i ndryshimeve të nevojshme legjislative me qëllim realizimin e një sistemi efektiv të ushtrimit të së drejtës së tubimit paqësor si një e drejtë e pamohueshme në një shoqëri demokratike dhe parandalimin e goditjen efikase të dhunës kundër institucioneve shtetërore si një realitet i papranueshëm në një shoqëri demokratike.

III. Hetimi i komisionit parlamentar nuk shtrihet për ato çështje dhe rrethana, për të cilat Prokuroria e Republikës së Shqipërisë ka filluar procedim penal sipas ligjit.

IV. Komisioni hetimor parlamentar përbëhet nga 11 deputetë. Kryetari i përket Partisë

Demokratike. Përbërja e komisionit është si më poshtë:

1. Eduard Halimi Kryetar PD
2. Gent Strazimiri Anëtar PD
3. Dashnor Sula Anëtar PD
4. Enkelejd Alibeaj Anëtar PD
5. Fatos Hoxha Anëtar PD
6. Viktor Gumi Anëtar PD
7. _____ PS
8. _____ PS
9. _____ PS
10. _____ PS
11. _____ PS

V. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat 3–mujor nga miratimi i këtij vendimi.

VI. Ngarkohen Kryetarja e Kuvendit dhe Sekretari i Përgjithshëm të krijojnë kushtet e nevojshme logjistike për veprimtarinë normale të këtij komisioni.

VII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
**Jozefina Topalli (Çoba)**